



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 para. 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna si dhe neneve 40, 41 dhe 67 para. 2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT – RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, të publikohet në WebFaqen e Komunës dhe tabelen e shpalljeve:

Projekt- Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet për Projekt Rregullorën për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit mund t'i dërgohen Komisionit për hartimin e kësaj Rregullore nëpërmjet Drejtoratit për Arsim, më së largu deri më 08.04.2022.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqën e Komunës.

1Nr. 016/01-12349
Lipjan, më 07.03.2022

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

